

AKT THEMELIMI I SHOQËRISË
“ICV HOUSE” SHPK

Ne mbështetje të Ligjit Nr.9901, datë 14.4.2008 “*Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare*”, vendosëm hartimin e këtij Akti Themelimi, me kushtet që përcaktohen si më poshtë:

Sot ne date 17.09.2021, ortaku:

Pamela Malasi, e bija e Gëzim-it, e datelindjes 31.12.1997, lindur në Ballsh dhe banues në Tirane, madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar e identifikuar prej letërnjoftim nr.033013259 dhe me nr. Personal J76231068T

me vullnetin e saj të lire dhe të plote, të shprehur nëpërmjet këtij akti themelimi, vendosi per krijimin e Shoqërisë tregtare “**ICV HOUSE**” SHPK me kushtet e mëposhtme:

Neni 1
EMERTIMI

Shoqëria Tregtare do te ketë Emërtimi “**ICV HOUSE**” Shpk.

Neni 2
FORMA JURIDIKE

Shoqëria Tregtare “**ICV HOUSE**” Shpk, themelohet si Shoqëri Tregtare me Përgjegjësi të Kufizuar sh.p.k. Shoqëria është Person Juridik Privat Shqipëtar. Shoqëria krijohet në bazë të Ligjit nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, ku ne nenin 3 përcaktohet se:

” 1. Shoqëritë tregtare themelohen nga dy ose më shumë persona fizikë dhe/ose juridikë, që bien dakord për arritjen e objektivave ekonomike të përbashkët, duke dhënë kontribute në shoqëri, sipas përcaktimeve në statutin e saj. Shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar dhe shoqëritë aksionare mund të themelohen edhe vetëm nga një person fizik dhe/ose juridik (shoqëritë me ortak apo aksionar të vetëm).

2. Shoqëritë tregtare duhet të regjistrohen sipas nenit 22 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, si dhe neneve në vijim, sipas formës përkatëse të shoqërisë tregtare.

3. Shoqëritë tregtare fitojnë personalitetin juridik në datën kur kryhet regjistrimi i tyre në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Shoqëritë përgjigjen me të gjitha aktivet e tyre për detyrimet, që rrjedhin nga veprimtaritë e ushtruara.”

NENI 3 SELIA

Selia e Shoqërise është ne adresen: Njesi me sipërfaqe 16.2 m2, Bulevardi/Rruga Bajram Curri, e regjistruar ne zk.8160, vol.39 fq.56, me nr pasurie 2/276-N30 te ZVRPP Tirane. Shoqëria mund te ndryshoje seline e tij, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikës se Shqipërisë, vetëm me vendim te Ortakut te Vetëm.

NENI 4 KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e shoqërisë “**ICV HOUSE**” Sh.p.k do te vazhdoje veprimtarine e saj me një afat kohor te pakufizuar.

Shpërndarja ose prishja e Shoqërise mund të behet ne cdo kohe :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të ortakut te vetem;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
- d) me vendim të gjykatës;

Në këte rast Ortaku i Vetem merr vendim me shkrim në të cilin parashikon menyren e likuidimit të Shoqërise, duke caktuar 1 apo disa likuidator dhe shënuar në çdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë “Shoqëri ne likuidim e sipër”.

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaku i Vetem.

Nëse Ortaku i Vetem nuk merr një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pasprishjes, çdo person i interesuar mund t’i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

NENI 5 OBJEKTI

Objekti i Shoqërise përfshin Shitje me shumicë e pakice e tekstileve, veshjeve, veshjeve sportive, këpuceve dhe artikujve të lëkures. Import, eksport, shitje me shumicë dhe pakicë e lodrave duke perfshirë por pa u kufizuar në to, lodra dhe figura të licencuara dhe lojra me plastelinë. Industri veshjeje, import-eksport, tregtim dhe shitje me pakice e shumice të mallrave, sipermarrje dhe shërbime në fusha të ndryshme. Gjithashtu, në perputhje me legjislacionin Shqiptar, Shoqëria mund të kryeje dhe realizoje çdo aktivitet qe lidhet direkt ose indirekt, që është pasoje, apo e lidhur me aktivitetet e listuara me lart. Për të arritur qëllimin e mësipërm, Shoqëria mund të

ndërmarrë çdo aktivitet dhe shërbim qoftë tregtar, financiar, për dhenie me qira apo hipotekim, që mund të konsiderohet i dobishëm apo i nevojshëm në mënyrë që të arrihet objekti i Shoqërisë.

Për këtë qëllim Shoqëria mund të veprojë si në Shqipëri dhe jashtë vendit. Kompania gjithashtu mund të veprojë nëpërmjet filialeve të saj apo të Shoqërive të kontrolluara prej saj. E gjithë kjo në respektim të legjislacionit që rregullon çështjet specifike të listuara më sipër, ndalimet, kufizimet dhe kërkesat ligjore dhe prandaj i nënshtrohen lejeve, autorizimeve dhe rregjistrimeve që mund të jenë të nevojshme me përputhje me të gjithë kushtet e tjera.

Shoqëria mundet se fundi në mënyrë industriale të kryej çdo veprim tregtar në lidhje me pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme. Gjithashtu Shoqëria mund të kryej çdo aktivitet tjetër biznesi i cili nuk është i ndaluar nga ligji i zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë.

NENI 6 KAPITALI I SHOQËRISË

Kapitali themeltar i Shoqërisë është i përzier nga kontributi i ortakëve themelues me vlerën 100 (njëqind) lekë dhe përbehet teresisht nga kapitali në para. Kapitali themeltar ndahet në 100% kuota me vlerë nominale të barabarta prej 100 (njëqind) lekë secila. Një kuotë përveç vlerës nominale të saj, ka edhe vlerën e një vote në mbledhjen e asamblese së ortakëve.

Në momentin e krijimit të Shoqërisë, Kapitali themeltar prej 100 (njëqind) lekë është paguar teresisht nga ortaku themelues. Në bazë të kontributit të paguar pjesëmarrja e ortakëve në kapitalin themeltar është ***Pamela Malasi, 100% të kapitalit dhe zoterues i 1 kuote.***

NENI 7 TRANSFERIMI I KUOTAVE

Kuotat e kapitalit janë lirish të Transferueshme ndërmjet Ortakëve. Ortaku që kërkon të shesë kuotën e tij një personi tjetër, duhet detyrimisht të njoftoj ortakëve të Shoqërisë blerjen e kuotave të tij në të njëjtat kushte si personit tjetër të cilit ai dëshiron t'ia shesë. Kur disa ortakë ushtrojnë të drejtën e tyre të parblerjes dhe shprehin dëshirën e tyre për të blerë kuotën, ortaku shitës gëzon të drejtën diskreacionale për të zgjedhur se cilit ortak ai dëshiron t'i shesë totalisht ose pjesërisht kuotat e tij. Ortaket duhet të përgjigjen brenda 30 ditëve nëse dëshirojnë të blejnë kuotat e ofruara apo jo.

Neni 8

SHPERNDARJA E FITIMIT

Ortakët financojnë, përfitojnë rimbursim të financimit të tyre dhe ndajnë fitimin e tyre në bazë të kuotave në kapitalin themeltar.

NENI 9

ORGANET DREJTUESE TË SHOQËRISË

Ortaku i Vetëm është organi i vetëm vendimmarrës i Shoqërisë.

Ortaku i Vetem është organi vendimmarres i Shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj. Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet prane QKB për të pasqyruar ndryshimet në skedën e Shoqërisë.

Aministratori i Shoqërisë është **Pamela Malasi**, e bija e Gëzim-it, e datelindjes 31.12.1997, lindur në Ballsh dhe banues në Tirane, madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar e identifikuar prej letërnjoftim nr.033013259 dhe me nr. Personal J76231068T.

Afati i emërimit të administratorit është per nje periudhe 5 (pese) vjecare.

Neni 10

Kompetencat

Administratori ka të drejtë dhe detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- d) përgatis dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- e) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- f) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- g) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

Administratori është i detyruar të thërrasi mbledhjen e ortakut te vetem edhe ne rastet kur:

- a) sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe
- b) kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara,

Administratori ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkalleve. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakut te Shoqërisë.

Administratori i Shoqërisë Znj.Pamela Malasi, ka te drejte që te realizoje derdhje ne llogarite bankare te Shoqërisë, të realizojë transferta, tërheqje apo çdo lloj veprimi tjetër në këto llogari.

Vetem personi i pajisur me autorizim (Prokurë e Posacme) nga Ortaku i Vetem i Shoqërisë Pamela Malasi ka te drejte te realizoje transferta, tërheqje apo cdo lloj veprimi tjetër ne llogarite bankare te Shoqërisë.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Neni 11

Veprimtaria ekonomike dhe financiare e Shoqërisë ndahet ne periudha financiare 12 mujore. Viti financiar fillon nga data 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor te cdo viti kalendarik, me perjashtim te vitit te pare I cili fillon nga data e krijimit te Shoqërisë dhe mbaron me 31 Dhjetor.

Neni 12

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Mbledhja e Ortakut te Vetem, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.

Mbledhja e Ortakut te Vetem vendos rreth shperndarjes se dividendit, pasi te jene zbritur humbjet e vitit te meparshem financiar, siç edhe parashikohet nga ligji.

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarisë ekonomiko tregtare të Shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë si ngarkuar nga ana e ortakut të vetëm.

Në përfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e dorëzojë në kohë ortakut për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

Neni 13

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Mosmarrëveshjet lidhur me themelimin dhe zhvillimin e veprimtarisë së Shoqërisë zgjidhen nga vetë ortakët e Shoqërisë me mirekuptim, dhe kur kjo nuk arrihet ato zgjidhen nga gjykata në territorin e së cilës ndodhet selia e Shoqërisë.

Neni 15

Ky Akt Themelimi u hartua në 4 (katër) kopje origjinale në gjuhën Shqipe.

ORTAKU I VETËM I SHOQËRISË “ICV HOUSE” Sh.p.k

PAMELA MALASI

